

**Njoftim për përqendrim me të cilin Korporata JAGEO, Tajvan do të fitojë kontrollin
mbi SHIBAURA ELECTRONIKS Ko., Ltd, Japoni
(lënda nr. 08-36/2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24), më datë 14.02.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Korporata JAGEO (JAGEO Corporation), me seli të regjistruar në 3F, 233-1, Baokiao Road., zona Ksindian., New Taipei City 23145, Tajvan do të fitojë kontroll të pavarur mbi SHIBAURA ELECTRONIKS Co., Ltd (SHIBAURA ELECTRONICS Co., Ltd), me seli të regjistruar në 2-1-24, Kamioçiai, Çuo-ku, Saitama City, Saitama 338-0001, Japoni, përmes blerjes së aksioneve.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

Korporata JAGEO është një ofruer global i zgjidhjeve për komponentë elektronikë, duke ofruar një gamë të gjerë teknologjish për komponentë pasivë nga disa nga markat më të njohura në industri "JAGEO". Korporata JAGEO është e listuar në Bursën e Tajvanit (2327-TW).

Korporata JAGEO ka qenë e pranishme në Maqedoninë e Veriut në vitin 2024 përmes shoqërisë të saj të varur në pronësi të plotë - Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime KEMET ELECTRONIKS MACEDONIA SHPKNJP Shkup, me NUAS 6685862, seli të regjistruar në Zonën Zhvillimore Teknologjike Industriale nr. 1 BB, Ilinden, Maqedonia e Veriut dhe veprimtari prioritarë të regjistruar: 26.11 - prodhimi i komponentëve elektronikë.

SHIBAURA ELECTRONIKS Co., Ltd është lider global në tregun e termistorëve. SHIBAURA ELECTRONIKS Co., Ltd është e listuar në Bursën e Tokios dhe punëson më shumë se 4,800 persona dhe realizon të ardhura në shumë prej mbi 32 miliardë JPY në mbarë botën. JAGEO supozon¹ arsyeshëm se Shibaura nuk ka qenë e pranishme në Maqedoninë e Veriut në vitin 2024 përmes ndonjë shoqërie të varur të regjistruar.

Sipas parashtruesve të njoftimit, si treg relevant për përqendrimin në fjalë mund të përcaktohet tregu i prodhimit dhe shitjes së termistorëve me koeficient negativ të temperaturës (NTK).

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën. Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail:

¹ Korporata JAGEO nuk është në gjendje të marrë informacione të sakta për aktivitetet biznesore të SHIBAURA ELECTRONIKS Co., Ltd në Maqedoninë e Veriut (ose globalisht) pasi Transaksioni i Propozuar përfshin një blerje armiqësore (hostile takeover) të aksioneve. Rrjedhimisht, Korporata YAGEO mbështetet vetëm në informacionet publikisht të disponueshme për Shibaura

kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

21.02.2025

Shkup